

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning


Departamenti i Ujërave / Departament Voda / Water Department

DATË/A:	31.05.2013
REFERENC-Ë:	1690-2/12 -ZSP- DU /2013
PËR/ZA/TO:	z. Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Dr. Sci. Naser BAJRAKTARI, Drejtor i Departamentit të Ujërave
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	VENDIM

Bazuar në kërkesën me Nr. të protokollit: 1690-2/12, Sektori i Lejeve Ujore i DU-së ka shqyrtuar lëndën dhe ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur.

Me respekt!

Faqe 1 nga 1



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/Kancelarija Opsteg Sekretara/Office of the General Secretary

DATË/A:	31.05.2013
REFERENC-Ë:	1690-2/12 - ZSP- 442 /2013
PËR/ZA/TO:	SH.P.K. „KOSOVA - TEX” , K. Prishtinë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Arben ÇITAKU, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Sipas kërkesës suaj me nr. të protokollit: 1690-2/12, organi kompetent i MMPH-së ka shqyrtuar aplikacionin për Leje Ujore dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkangjitur të kësaj letër përcjellëse.

Me respekt !

Faqe 1 nga 4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përhershëm/Kancelarija Stalnoq Sekretara/Office of the Permanent Secretary

Në bazë të nenit 56.1 të Ligjit Për Ujërat e Kosovës (Nr. 2004/24) dhe nenit 98 të LPA-së me Nr. 02/L-28, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor pas shqyrtimit të kërkesës ka nxjerrë këtë:

LEJE UJORE

APROVOHET kërkesa e kompanisë „KOSOVA –TEX” K. Prishtinë, për shfrytëzimin e ujit nga Puset, për fabrikën e tekstilit.

Leja Ujore jepet me këto kushte :

- Sasia maksimale e shfrytëzimit të ujit nga Pusi I, me koordinata X= 7540236.97, Y=4720519.30 është 3.5 l /s (tre pikë pesë, liter për sekond), si dhe Pusi II me koordinata X= 7540247.60, Y=4720530.02 është 3.5 l /s (tre pikë pesë, liter për sekond) të parapara sipas dokumentacionit teknik;
- Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësve të vendosur në puse, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m³/ditë), sasinë vjetore (m³/muaj) dhe sasinë vjetore (m³/vit). Për sasinë e shfrytëzuar pala obligohet që për çdo tre muaj të informoj me shkrim MMPH-në;
- Obligimi për pagimin e kompensimeve për shfrytëzimin e ujërave, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPH-ja, sipas U.A. Nr. 06/2006, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
- Për këtë pala obligohet të raportoj mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;



Faqe 2 nga 4

- Leja ujore nuk munde te kalohet tek personat e tretë pa pajtimin e organit i cili e ka lëshuar Lejen;
- Afati i lëshimit të Lejes Ujore është 2 vjet, me mundësi zgjatjeje sipas kërkesës së palës;
- Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që së paku 6 (gjashtë) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdim të përdorimit;
- Pala për ndryshim te shfrytëzimit të ujit apo destinimit, duhet të aplikoj për ndryshim të Lejes ujore, per sasinë e shtuar të shfrytëzimit, apo ndryshim te destinimit me gjithë dokumentacionin përkatës relevant dhe me elaborat për shfrytëzim.

Arsyetim

Sipas kerkesë më Nr. të prot. 1690-2/12, SH.P.K. “KOSOVA-TEX”, K. Prishtinë, ka aplikuar për Leje Ujore, lidhur me shfrytëzimin e ujit nga puset për furnizimin e fabrikës së tekstilit.

Pala kërkesës i ka bashkangjitur këtë dokumentacion investivo-teknik:

1. Formularin e aplikimit për Leje Ujore;
2. Pëlqimi mjedisore;
3. Fatura e paguar Nr. 000440;
4. Kopja e planit;
5. Plani i situacionit;
6. Analiza kimiko- fizike dhe mikrobiologjike;
7. Elaborati per leje ujore.

Në kuadër të procedurave për shqyrtim të kërkesave nga grupi punues të DU-së, datë 11.04.2013, është kryer shikimi në vend për të dy puset. Gjatë shikimit në vend është mbajtur procesverbali me nr. rendor 11/2013 dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi i DU-së dhe palës.

Në bazë të dokumentacionit – investivo teknik të dorëzuar, shikimit në vend dhe në harmoni me politikat zhvillimore ekonomike të Kosovës është vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.



KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Nr: 1690-2/12 -ZSP- ~~442/13~~ Datë: 31.05.2013
Prishtinë

T'i dërgohet :

1. Palës,
2. Kabinetit të Ministrit,
3. K. Prishtinë,
4. Zyrërishtine së Sekretarit të Përgjithshëm,
5. DU-së,
5. Arkivit të MMPH-së.

Sekretar i Përgjithshëm



Faqe 4 nga 4